

**VENDIM**  
**Nr. 727, datë 12.12.2018**

**PËR KRITERET DHE MASËN E PËRFITIMIT TË KOMPENSIMIT, NË RAST  
HUMBJEJE TË JETËS NË DETYRË OSE PËR SHKAK TË SAJ, TË PUNONJËSIT  
CIVIL DHE PERSONIT CIVIL QË KA KRIJUAR MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI  
TË FSHEHTË ME AGJENCINË E INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË  
MBROJTJES (AISM)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 56, të ligjit nr. 65/2014, “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Familja e punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM), që humbet jetën në detyrë ose për shkak të saj, si dhe familja e personit civil që ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi të fshehtë me këtë agjenci dhe humbet jetën për shkak të këtij bashkëpunimi, trajtohen me kompensim të veçantë sipas kriterëve dhe masës së përcaktuar në këtë vendim.

2. Raste të “Humbjes së jetës në detyrë” të punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) të quhen ato raste kur punonjësi humbet jetën:

a) Gjatë kohës së kryerjes së detyrës ose për shkak të saj, kur ngjarja ka ndodhur për arsye që lidhen me detyrën;

b) Jashtë kohës së kryerjes së detyrës, kur shkak për ndodhjen e ngjarjes janë veprimet e ligjshme të punonjësit në kryerjen e detyrës.

3. Raste të “Humbjes së jetës në detyrë” të personit civil që ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi të fshehtë me Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) të quhen ato raste kur punonjësi humbet jetën:

a) Gjatë kohës dhe për shkak të bashkëpunimit të fshehtë;

b) Jashtë kohës së bashkëpunimit, kur shkak për ndodhjen e ngjarjes janë veprimet e ligjshme të individit për shkak të bashkëpunimit të fshehtë.

4. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) është përgjegjëse për përgatitjen e dokumentacionit që vërteton ekzistencën e rasteve, në zbatim të pikës 2 dhe/ose 3, të këtij vendimi, pas vërtetimit të rastit të humbjes së jetës, për shkaqe jonatyrale, nga organet kompetente.

5. Kompensimi që përfiton familja me anëtarë bashkëshorten/bashkëshortin, fëmijët nën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur kryejnë studimet e larta, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari, në çastin e humbjes së jetës së punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) dhe personit civil që ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi të fshehtë me këtë agjenci, të jetë në masën jo më pak se 200 000 (dyqind mijë) lekë për çdo anëtar, pasi të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm:

a) Vendimi apo vërtetimi nga organi i drejtësisë që shprehet për shkakun e humbjes së jetës;

b) Vërtetimi i titullarit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) për “Humbje të jetës në detyrë”, në zbatim të pikës 4, të këtij vendimi;

c) Certifikatë e gjendjes familjare në datën e ndodhjes së ngjarjes;

ç) Certifikatë vdekjeje e punonjësit të agjencisë ose personit civil që ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi të fshehtë me agjencinë;

d) Kopje të dokumentit të identitetit të personit që përfiton kompensimin.

6. Procedurat për dhënien e kompensimit të veçantë përcaktohen me udhëzim të ministrit të Mbrojtjes.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë

së Mbrojtjes.

8. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**